



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 116, datë 30.09.2021

**PËR**

**DETAJIMIN E FONDIT TË PËRFITUAR NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.514, DATË 18.09.2021 “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E ZBATIMIT, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT PËR REHABILITIMIN E INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN E PORTO ROMANOS – KËNETË DHE SISTEMIMIN E RRJETIT TË UJËRAVE TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË DURRËSIT DHE CAKTIMIN E BASHKISË DURRËS SI NJËSI ZBATUESE”**

Në zbatim të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshimet përkatëse, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.775, datë 30.09.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, nga Bashkia Durrës, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për Hartimin e Projektpreventivit dhe Riforcimin e Hidrovorit të Durrësit” i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 213, datë 31.03.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për hartimin e studim projektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kulimit në zonën e Porto Romanos – Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.514, datë 18.09.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto Romanos – Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit dhe caktimin e Bashkisë Durrës si njësi zbatuese”, Udhëzimit nr.2 të Këshillit të Ministrave, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhëzimit Nr.3 të Këshillit të Ministrave, datë 15.2.2001 “Për Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe

Infrastrukturës Publike, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e detajimit të fondit prej 1 990 639 140.6 lekë të përfituar në zbatim të VKM nr.514, datë 18.09.2021 në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas tabelës së mëposhtme:


Gr.	Kap.	Prog-ram	Llog.eko	Kodi produktit	Emërtimi	Vlera e plotë (në lekë)	Financimi për vitin 2021 (në lekë)	Financimi për vitin 2022 (në lekë)
00	1	04960	231	94902AE	Rehabilitimi i infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto Romanos – Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit	1,972,599,359.27	394,658,640.00	1,577,940,719.27
00	1	04960	231	94902AE	Mbikqyrje	17,345,943.59	3,469,188.00	13,876,755.59
00	1	04960	231	94902AE	Kolaudim	693,837.74		693,837.74
00	1	04960	231	94902AE	<b>TOTAL</b>	<b>1,990,639,140.60</b>	<b>398,127,828.00</b>	<b>1,592,511,312.60</b>

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).


**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 01.10.2021**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 754/prot.  
10.



Durrës, më 05.10. 2021

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK** ✓  
**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.116 datë 30.09.2021 “Për detajimin e fondit të përfituar në zbatim të Vendimit të Këshillit Të Ministrave nr.514, datë 18.09.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto Romanos – Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit dhe caktimin e Bashkisë Durrës si njësi zbatuese”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

